



Lajmet e Fundit: Policia Rugore vijon intensivisht kontrollet dhe monitorimin e qarkullimit të automjeteve



Lajmet

19/09/2021

Shkodër – Qarkullonte me armë zjarri me vete, vihet në pranga 42-vjeçari

Shkodër

Kontrolle të shtuara në të gjithë qarkun, për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje.

Qarkullonte me armë zjarri me vete, vihet në pranga 42-vjeçari.

Sekuestrohet 1 armë zjarri pistoletë me një krehër me 7 fishekë.

Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Shkodër, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale të DVP Shkodër në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, kanë ushtruar kontroll, për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri.

Gjatë kontrolleve në vendin e quajtur rruga e Golemit, shërbimet e Policisë, kanë gjetur në automjetin e 42 vjeçarit, poshtë sediles së drejtuesit mjetit një armë zjarri pistoletë me një krehër me fishekë.

Në përfundim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit G. C., 42 vjeç, për veprat penale “Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe e municionit”.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprime të mëtejshme procedurale.



Share



Share



Share



Share



Email

◀ Lezhë – Goditen 2 raste të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit

Shkodër – Vihen në pranga 4 shtetas për shpërdorim të tokës, shkatërrim i pronës me mjete të tjera dhe për ndërtim të paligjshëm ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)